



Nr. 02/14

Datë: 24.10.2014

Prishtinë

Në mbështetje të nenit 9 pika 2 dhe të nenit 106 pika 1 të Statutit të Fakultetit të Studimeve Islame (në tekstin e mëtejme FSI), në mbështetje të propozimit të Komisionit për hartimin e Draft-Rregullores për studime në FSI, Këshilli Mësimor-Shkencor i FSI-së në mbledhjen e mbajtur më datë 24.10.2014 Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës i propozon:

RREGULLOREN

Për studime në FSI

I. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Rregullorja për studime mbështetet në Statutin e FSI-së dhe plotëson dispozitat e tij.

Neni 2

Kjo rregullore aplikohet në FSI dhe obligon si studentët edhe personelin akademik dhe administrativ në aplikimin e saj.

Neni 3

Qëllimi i nxjerrjes së kësaj Rregulloreje është:

- a) Të përcaktojë formën e punës mësimore, shkencore dhe edukative;
- b) Të përcaktojë formën e vlerësimit të studentëve;
- c) Të përcaktojë kushtet që duhet të plotësojë studenti për t'iu nënshtruar provimit;
- d) Të përcaktojë kushtet për regjistrimin e vitit;
- e) Të rregullojë çështjen e riprovimit;
- f) Të përcaktojë rregulla të tjera që kanë të bëjnë me studentët.

Neni 4

- 1) Në Fakultet, format kryesore të punës mësimore janë: ligjëratat, mësimet speciale individuale dhe kolektive, seminarët, kolokfiumet, praktika profesionale, detyrat e kursit, provimet përfundimtare.
- 2) Njësia akademike, me miratimin e KMSH-së, mund të përcaktojë edhe forma tjera të punës mësimore, veçmas të verifikimit të dijeve të fituara.

Neni 5

- 1) Leksionet si formë e punës mësimore, si rregull janë me pjesëmarrje të detyrueshme. Specifikat e lëndëve përcaktojnë shkallën e detyrueshmërisë së vijimit të rregullt.
- 2) Mësimdhënësit në syllabusët e tyre përcaktojnë detyrueshmërinë e vijimit.

Neni 6

Studenti mund t'ju nënshtrohet provimeve në këto afate:

- a. Afati i Janarit,
- b. Afati i Prillit - vetëm për studentët me korrespondencë, (shih: Statuti i FSI-së neni 70)
- c. Afati i Qershorit,
- d. Afati i Shtatorit,
- e. Afati i Nëntorit - vetëm për studentët e rregullt, (shih: Statuti i FSI-së neni 70)

Neni 7

Suksesi i studentit në provim apo vlerësime tjera të dijes, vlerësohet me nota si vijon:

- a) 10 (A) – (Shkëlqyeshëm, prej 91 deri 100 pikë);
- b) 9 (B) – (Shumë mirë, prej 81 deri 90 pikë);
- c) 8 (C) – (Mirë, me disa gabime që vërehen prej 71 deri 80 pikë);
- d) 7 (D) – (Kënaqshëm, me gabime domethënëse prej 61 deri 70 pikë)
- e) 6 (E) – (Mjafton, përmbushje e kritereve minimale, prej 51 deri 60 pikë);
- f) 5 (F, FX) – (mospërmbushje të kritereve minimale, nën 50 pikë).

Në format e verifikimit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultat i cili, detyrimisht, kthehet në notë.

Neni 8

1. Për t'ju nënshtruar provimeve në cilindo afat të provimeve, studenti është i obliguar t'i paraqes provimet;
2. Në provim mund të hyjnë vetëm studentët të cilët janë në listën e studentëve dhe të cilët nuk kanë obligim ndaj Fakultetit;
3. Lista e përpiluar e studentëve të cilët kanë të drejtë të hyjnë në provim duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme rreth provimit, mësimdhënësit dhe studentëve;
4. Listat e studentëve që do të hyjnë në provime, publikohen së paku 3 ditë para datës së mbajtjes së provimeve;
5. Lista e studentëve mund të plotësohet dhe gjenerohet së paku deri 1 ditë para mbajtjes së provimeve (kjo bëhet me listë plotësuese).

Neni 9

1. Studentët e rregullt janë të obliguar të iu nënshtrohen afateve të kollektivimeve dhe u ndalohet hyrja në provime në afatin e rregullt prej 100 pikëve.
2. Studentët me korrespondencë nuk kanë të drejtë të hyjnë në kollektivime.

Neni 10

1. Komunikimi i rezultatit të provimi bëhet më së largu shtatë (7) ditë pas mbajtjes së provimit;
2. Komunikimi i rezultateve të provimit bëhet përmes listës që shpallet dhe në të përfshihet vetëm numri identifikues i studentit (numri i indeksit) dhe rezultatet e provimit;
3. Refuzimi i notës mund të bëhet brenda afatit prej 24 orësh nga data e komunikimit të rezultatit;
4. Studenti është i obliguar që refuzimin e notës ta bëjë tek referenti për çështje të studentëve dhe atë brenda afatit të paraparë në paragrafin e mësipërm
5. Nota e përshkruar në raportin përfundimtar që dorëzohet në administratë, nuk mund të refuzohet dhe paraqet notën përfundimtare;

Neni 11

Profesori detyrohet që në administratë të dorëzoj raportin origjinal të vërtetuar me nënshkrimin e tij, ndërsa tek ai mbetet kopja e të njëjtit.

Afati për dorëzimin e raportit përfundimtar është maksimumi 10 ditë nga dita e mbajtjes së provimit.

Neni 12

Studenti i pakënaqur me vlerësimin e profesorit, brenda 2 ditëve nga komunikimi i notës dhe pas konsultimit me profesorin e lëndës mund të ushtrojë ankesë me shkrim Dekanit të Fakultetit përmes Sekretarit. Ankesa duhet të jetë e arsyetuar.

Në bazë të arsyeshmërisë së ankesës, Dekani vendos për emërimin e Komisionit tre anëtarësh për vlerësimin e studentit.

Kryetarin dhe dy anëtarë të Komisionit i emëron Dekani në afat prej 24 orësh nga marrja e ankesës.

Njëri nga anëtarët e Komisionit duhet të jetë nga lënda e ngjashme, ndërsa pyetësi me notën e të cilit student i nuk ka qenë i kënaqur nuk mund të jetë kryetar komisioni dhe nuk përcaktohet detyrimisht që ky të jetë anëtar i komisionit.

Dekani e cakton kohën e mbajtjes së provimit në afat prej tre ditësh nga paraqitja e kërkesës së studentit.

Komisioni merr vendim me shumicë votash. Vendimi i komisionit paraqet akt përfundimtar kundër të cilit nuk mund të ushtrohet ndonjë mjet.

Rezultati i provimit shkruhet në një vendim të veçantë të Komisionit, të nënshkruar nga tre anëtar, i cili vendim duhet t'i bashkëngjitet raportit të provimit nga e njëjta lëndë.

Neni 13

Provimi nga e njëjta lëndë mund të përsëritet më së shumti 5 herë. Studenti i cili edhe herën e pestë nuk e kryen provimin, me kërkesën e tij provimit mund t'i nënshtrohet para komisionit të themeluar nga dekanati i Fakultetit.

Nëse student i nuk e kalon provimin edhe herën e pestë, si dhe para komisionit, ai student detyrohet t'i përcjell edhe njëherë ligjëratat dhe ushtrimet e lëndës përkatëse.

Nëse student i edhe pas ri-regjistrimit të lëndës nuk e kryen provimin në mënyrën e përcaktuar në paragrafin e mësipërm, ai humb të drejtën e studimit.

Neni 14

Studenti fiton të drejtën për regjistrimin e vitit vijues si vijon:

- 1) Fiton të drejtën e regjistrimit të vitit të II (dytë) nëse nga viti i parë ka siguruar mbi 30 ECTS
- 2) Fiton të drejtën e regjistrimit të vitit të III (tretë) nëse ka përfunduar të gjitha obligimet nga viti i I (parë) dhe ka siguruar minimum 24 ECTS nga viti i II.

- 3) Fiton të drejtën e regjistrimit të vitit të IV (katërt) nëse ka përfunduar të gjitha obligimet nga viti i I (parë) dhe i II (dytë) dhe ka siguruar minimumi 24 ECTS nga viti III.

Neni 15

Kontrolli i lëndëve profesionale (provim ose kontroll semestral) bëhet në forma specifike.

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) mund të bëhet:

- Me shkrim,
- Me gojë,
- I kombinuar, me shkrim dhe me gojë.

II. Kontrolli i dijes

Neni 16

Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e lëndës, kur përmbush detyrimet vjetore që lidhen me atë lëndë, të parashkuara me planin mësimor.

Emrat e studentëve që kanë fituar të drejtën për të hyrë në provimin e lëndës përfshihen në listën e provimit. Ajo nënshkruhet nga Sekretari i Fakultetit dhe mban vulën e Fakultetit. Me përfundimin e provimit, e njëjta dorëzohet në sekretari.

Në asnjë rast fleta e provimit nuk duhet të ketë korrigjime dhe askush nuk ka të drejtë të shtoj emra në të.

Marrja në dorëzim e saj bëhet me nënshkrim (firmë)

Neni 17

Provimet dhe riprovimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik, miratuar nga dekanati i Fakultetit. Datat e tyre propozohen nga Fakulteti – departamenti dhe shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të afatit.

Neni 18

Provimet nuk janë publike dhe pjesëmarrja e publikut nuk është e lejuar. Publiku mund të marr pjesë vetëm në mbrojtjen publike të punimit të diplomës (BA).

Neni 19

Provimet zhvillohen në orën dhe datën e caktuar. Në rast pamundësie të zhvillimit të provimit ditën e caktuar, Dekani, me urdhër me shkrim, e anulon atë dhe cakton një datë të mëvonshme, e cila u bëhet e njohur studentëve.

Neni 20

Studenti, i rregullt ose me korrespondencë, nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një lënde, brenda një afati.

Studenti paraqitet në provim me dokument identifikimi me fotografi (indeks ose kartë identifikimi të Fakultetit).

Neni 21

Studentët që lëvizin në kuadrin e projekteve e programeve ndërkombëtare në të cilat merr pjesë Fakulteti, nuk kanë nevojë të dëshmojnë pjesëmarrjen në procesin mësimor. Nëse studentët kanë dhënë provimet jashtë shtetit dhe në Fakultetet (Universitetet) të tjera nga lëndët e ngjashme, atyre u njihen ato provime dhe nuk kanë nevojë të paraqiten në ato provime nëse janë në përputhshmëri me plan-programin e FSI-së.

III. Diplomimi

Neni 22

Në përfundim të studimeve, studentët që diplomojnë, fitojnë titullin përkatës profesional nga lëmi që ka studiuar;

Kandidati i cili nuk arrin të diplomojë në sesionin e parë të mbrojtjes së diplomës, ka të drejtë të ri-paraqitet për mbrojtje në sesionin e ardhshëm;

Mënyra e paraqitjes së punimit të diplomës dhe përgatitjes së saj është e rregulluar me Rregullore të veçantë të aprovuar nga Këshilli Mësimor-Shkencor i FSI-së

Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën (temën e diplomës), pajiset me diplomë përkatëse;

Diploma plotësohet qartë dhe nënshkruhet nga Dekani i FSI-së pastaj nga Kryetari i Kryesisë së BIRK-ut. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e thatë të Institucionit.

Neni 23

Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, me nënshkrim dhe evidentohet në regjistrin përkatës të të diplomuarve.

Nëse prania e të diplomuarit është e pamundur, tërheqjen e diplomës mund ta bëjë një nga pjesëtarët e familjes, duke treguar dokumentin e identifikimit ose ndonjë person i autorizuar me shkrim.

Neni 24

Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari duhet të mos e tërheq atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt.

Nëse i interesuari e tërheq diplomën e parregullt, në rast se i humbet origjinali ose i dëmtohet, duke iu bërë e papërdorshme atëherë Fakulteti mund të lëshoj diplomë dublikate. Diploma dublikate lëshohet sipas kushteve dhe procedurave në vijim:

- a. Studenti duhet të shpall të pavlefshme diplomën e humbur në njërin nga gazetatat ditore;
- b. Ekstrakti nga gazeta ditore duhet të arkivohet në dosjen e studentit;
- c. Diploma lëshohet me të dhënat e njëjta sikur diploma paraprake;
- d. Në këndin e djathtë lartë shënohet shenja “DUPLIKAT”, numri i protokollit dhe data lëshimit (kjo mund të jetë edhe një vulë që përmban këto të dhëna);
- e. Të dhënat në diplomë përshkruhen dhe janë të njëjta me parapraken përveç shtimit të të dhënave nga pika e mësipërme;
- f. Procedura dhe detajet tjera për lëshimin e diplomës mund të rregullohen me rregullore të veçantë.

Neni 25

Ceremonia për dorëzimin e diplomave, organizohet një herë në vit. Studentët që nuk mund të jenë prezent në ceremoni, mund ta marrin diplomën më vonë personalisht.

IV. Të drejtat dhe detyrimet e studentit dhe mësimdhënësit

Neni 26

Studenti ka të drejtë:

- a) Të marrë pjesë në ligjërata, seminare dhe aktivitete të tjera mësimore;
- b) Të përdor të gjitha instalimet dhe pajisjet e Fakultetit, sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor e shkencor;
- c) Të përdor librotekën sipas rregullave të përcaktuara nga dekanati i Fakultetit
- d) Të përfaqësohet në Këshillin e Fakultetit në përputhje me Statutin dhe rregulloret përkatëse;
- e) Të organizohet në shoqata të ndryshme jo politike në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse konform Statutit të FSI-së
- f) Të ushtroj të drejtën e tij për ankesë lidhur me procesin e mësimdhënies ose lidhur me lokalet ku mbahet mësimi.

Neni 27

Studenti me të përfunduar studimet ka të drejtë të bëjë përmirësimin e më së shumti dy notave.

Studenti duhet t'i parashtojë kërkesë dekanatit të fakultetit për përmirësim të notës, kërkesa duhet të jetë e arsyetuar.

Pas aprovimit të kërkesës, studenti në afatin e rregullt vijues, mund t'i nënshtrohet provimit për ngritjen e notës nga lënda përkatëse.

Për përmirësimin e notës studenti provohet vetëm një herë dhe mbetet në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund.

Neni 28

Studenti i cili në afatin e qershorit me sukses përfundon vitin akademik dhe arrin notën mesatare 9.5 e sipër, mund t'i lejohet të hyjë në provime të vitit vijues në afatin e shtatorit edhe pa dëgjuar ligjëratat.

Studenti që dëshiron të shfrytëzojë të drejtën nga alineja 1 e këtij neni, duhet të paraqes kërkesë pranë dekanatit të fakultetit dhe të njëjtës t'ia bashkëngjis certifikatën e notave, si dëshmi për provimet e kryera dhe për mesataren e kërkuar.

Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit vendos në bazë të kërkesës për përgjigje pozitive apo negative.

Neni 29

Studenti apo studentët kanë të drejtë të ankohen për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa paraqitet në dekanat brenda 48 orëve nga momenti i përfundimit të provimit.

Dekani i fakultetit, pasi verifikon shkeljet e reklamuar, së bashku me komisionin e provimit merr vendimin e formës së prerë.

Në rast se ankesa është e drejtë, Dekani vendos anulimin e provimit brenda tri ditësh nga dita e ankesës dhe urdhëron përsëritjen e tij në një datë të veçantë brenda atij afati të provimeve.

Neni 30

Studenti është i detyruar:

- a) Të respektoj medhhebin hanefi;
- b) Të njoh në hollësi rregullat e Fakultetit dhe detyrimet e tij dhe të jetë i vetëdijshëm për respektimin e tyre, në të kundërtën Fakulteti nuk mban përgjegjësi për pasojat e mundshme si rezultat i mosnjohjes së tyre;
- c) Të njoh dhe të zbatojë me përpikëri rregullat e mësimin dhe detyrimet e tij;

- d) Të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara me planin mësimor dhe programet e lëndëve;
- e) Të respektojë të drejtat e personelit të Fakultetit dhe të studentëve të tjerë;
- f) Të ruajë prestigjin dhe dinjitetin e Fakultetit;
- g) Është obligim i të gjithë studentëve dhe studenteve që të respektojnë rendin, disiplinën, kodin etikë-moral, kodin e veshjes, dukjen dhe pamjen në harmoni me dispozitat dhe traditat Islame.

Neni 31

Shkelje të rregullave të Fakultetit konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që cenojnë personalitetin e mësimdhënësit dhe të çdo punonjësi tjetër të Fakultetit, normat etiko – morale, si: kopjime në provim, falsifikimi i dokumenteve të ndryshme, aktet jo morale, vjedhja etj. Kur këto veprime nuk bartin elemente të veprës penale;

Ndaj studentit që kryen këto veprime, do të iniciohet procedura disiplinore në bazë të rregullores mbi procedurën disiplinore.

Masa më e lehtë disiplinore është vërejtja, kurse masa më e rëndë është përjashtimi i përhershëm nga Fakulteti.

Neni 32

Të drejtat dhe detyrimet e mësimdhënësit përcaktohen me kontratën e punës dhe me aktet e tjera të Fakultetit.

Neni 33

Afati maksimal i përfundimit të studimeve të plota universitare është deri në dyfishin e afatit të rregullt.

Studentët që nuk arrijnë të përfundojnë studimet brenda këtij afati, humbasin të drejtën e vazhdimit të studimeve.

Të drejtën e vazhdimit të studimeve e humbasin edhe studentët të cilët shpallen përsëritës të të njëjtit vit akademik dy herë.

Afati maksimal për mbrojtjen e temës së diplomës është deri dy vjet nga koha e përfundimit të studimeve.

V. Dispozita kalimtare

Neni 34

Në rast se dispozitat e kësaj Rregulloreje bien ndesh me dispozitat e Statutit të FSI-së apo dispozitat e Ligjit të Arsimit të Lartë, përparësi kanë dispozitat e Statutit dhe të LAL-it.

Neni 35

Rregullorja e Fakultetit mund të ndryshohet sipas procedurës së miratimit të saj.

Neni 36

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kryesia e BIRK-ut dhe fillon të aplikohet prej fillimit të vitit akademik 2014/2015.

Gjeneratat e mëparshme i përfundojnë studimet sipas rregullores së vjetër.

Vërteton:

Prof. asoc. Dr. Fahrush Rexhepi